



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3588 prot.

Fushë-Arrëz, më 12.11.2025

Procesverbal i mbledhjes së Kryesisë së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 17; 56; 57 dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 12.11.2025, në sallën e mbledhjeve të këshillit, Kryesia e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e radhës.

Anëtarët e kryesisë vijuan me diskutimin e pikave të rendit të ditës për mbledhjen e datës 27.11.2025 për të cilat u ra dakort.

U ngarkua Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë dhe personat apo edhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili anëtar këshilli.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

KRYESIA

Nr. 3588 prot.

Fushë-Arrëz, më 12. 11. 2025

VENDIM

PËR

“MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË RADHËS TË KB”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 17, neni 56, neni 57; Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz miratuar me VKB nr.15, datë 27.04.2020, Kryesia e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 12.11.2025,

VENDOSI

1. Miratimin e Njoftimit dhe Rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 27.11.2025, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit me rendin e ditës te çdo Këshilltar, te Kryetari i Bashkisë, personat apo organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili Këshilltar.
3. Ky vendim hy në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

